"Njëri prej tyre kishte armë", pasi i bllokojnë rrugën dy makina, dy të panjohur i afrohen mjetit të Salvador Kaçaj, policia: Po hetojmë

14 Maj, 2023 19:31

Madhësia e tekstit:

Ish-kreu i komunës së Shëngjinit, Salvador Kaçaj ka bërë një kallëzim në policinë e Lezhës pasi dy automjete i kanë bllokuar rrugën teksa lëvizte në aksin rrugor Lezhë-Milot.

Në denoncimin e tij ai thotë se nga automjetet kanë zbritur dy persona të panjohur, ku njëri prej tyre është afruar me vrap në drejtim të mjetit të tij dhe dyshohet se në dorë mbante një pistoletë.

Në njoftimin e policisë theksohet se Kaçaj ishte duke lëvizur me makinë bashkë shoferin dhe me djalin.

NJOFTIMI:

Rreth orës 18:00, është paraqitur në Komisariatin e Policisë Lezhë shtetasi S. K. 56 vjeç, banues në Lezhë, dhe ka bërë kallëzim se ka qenë duke lëvizur me mjetin e tij së bashku me djalin e shoferin, në aksin rrugor Lezhë-Milot, dhe konkretisht sapo kalon vendin e quajtur M+, dy automjete i kanë dalë përpara duke i bllokuar rrugën.

Nga automjetet kanë zbritur dy persona të panjohur prej tij, ku njëri prej tyre është afruar me vrap në drejtim të mjetit të tij dhe dyshohet se në dorë mbante një pistoletë.

Drejtuesi i mjetit ku udhëtonte shtetasi S.K., ka manovruar duke e kthyer mjetin në drejtim të Lezhës dhe kanë ardhur menjëherë në polici ku kanë bërë edhe kallzimin.

Në lidhje me kallzimin e shtetasit S.K., shërbimet e Policisë kanë njoftuar menjëherë Prokurorin si dhe nën drejtimin e tij, po kryejnë të gjitha veprimet hetimore dhe procedurale me qëllimin zbardhjen e plotë të rrethanave të ngjarjes, identifikimin dhe kapjen e autorëve të dyshuar.

(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit '**Balkanweb**' mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: lezhe

Download on the App Store | GET IT ON Google Play

Kerko ketu

LAJMET E FUNDIT

Detajet/ Sherri mes adoleshentëve nisi në rrjetet sociale dhe përfundoi në tragjedi. Si ndodhi vrasja e 15-vjeçarit në Gramsh, i plagosur dhe kushëriri i tij
17 Maj, 2023

Më nxehtë, më thatë dhe më me diell, çfarë po ndodh me klimën evropiane?
17 Maj, 2023

Rusia intensifikon luftimet në Ukrainë. Kievi presion aleatëve të tij që t'i ofrojnë më shumë pajisje ushtarake
17 Maj, 2023

Zgjedhjet në Turqi, si e ktheu Erdogan lojën në favor të tij, mbështetësi që mori në zonat e goditura nga tërmeti
17 Maj, 2023

Nuk deklaroi dëbimin nga Italia 16 vite më parë, nis verifikimi për kandidatin fitues të PS për Vaun e Dejës, Kristian Shkrelë
17 Maj, 2023

"Dëshmitarët e Jehovait padi ndaj qeverisë se nuk i financon", DASH njëzet raportin për Birësi fetare: Ja problemet në Shqipëri, Kosovë e RMV
17 Maj, 2023

NA NDIQNI NË RRJETET SOCIALE

@balkanweb

TË NGJASHME

PS fiton një fjetër bashkë, Pjerin Ndreu siguron mandatin e dytë
15 Maj, 2023

Voton kandidati i "BF" në Lezhë, Pashk Çjoni: Procesi vjen i qetë, gjatë natës rrëmujë e presione. Oytetarët të marrin pjesë në votime
14 Maj, 2023

Taboola Feed

If you have nail fungus, do this immediately
Eelbee | Sponsored
Get Offer

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
No Install. Play for free.
Combat Siege | Sponsored
Play Now

Policia ndalon ish-banoren e "Big Brother VIP", zbulohet arsyeja
Policia ndalon ish-banoren e "Big Brother VIP", zbulohet arsyeja
balkanweb.com


Liposuction In Mexico: Prices May Surprise You!
Liposuction Cost | Sponsored

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Detajet/ Sherri mes adoleshentëve nisi në rrjetet sociale dhe përfundoi në tragjedi. Si ndodhi vrasja e 15-vjeçarit në Gramsh, i plagosur dhe kushëriri i tij
17 Maj, 2023

Po udhëtonin 4 persona, mes tyre edhe 1 fëmijë/ Merr flakë në ecje makina në Qafë Thanë, detaje
16 Maj, 2023

Derbi Tirana-Partizani do "paralizojë" kryeqytetin, Policia e Shtetit publikon masat
16 Maj, 2023

Përmdiqte vazhdimisht një 18-vjeçare, arrestohet i riu në Gjirokastër
16 Maj, 2023

Incident në ambientet e KZAZ nr 35 në Tiranë, po ndiqte procesin e numërimit të votave, rëzohet nga shkallët Adriana Kalaja
16 Maj, 2023

Sherri mes adoleshentëve i mori jetën 15-vjeçarit në Gramsh, shoqërohet në polici autori dhe bashkëpunëtorët
16 Maj, 2023

KATEGORIA VIDEO

"Foltorja dhe PD të çmobilizohen", Gjekmarkaj: Berisha të largojë veten dhe familjen nga partia. Ja si mund të "shpëtohet" Partia Demokratike nga asgjësimi
17 Maj, 2023

"PS mori bastionet e PD, të djathtët i thanë 'stop' Berishës"/ Godole përpëlaset me analistin: Mos bëj zhurmusën! Lidershipi i vjetër u kthye në 'oktapod'
17 Maj, 2023

"Gjysha shantazhuese e Ramës, problem i fushatës", Godole: Mësi i Berishës dhe Metës ka rënë, mbijetojnë me alibi
16 Maj, 2023

"Lokalet"/ Analisti: Zgjedhje je të barabarta. Opozita u caktua nga drejtësia e mazhoranca. Pano Sokoi: Populli dha mesazh, refuzoi kastën e vjetër
16 Maj, 2023

"PD i ka parë njerëzit në 32 vite si ushtarë të bindur"/ Gjekmarkaj për fitoren e PS: Këto samarë i drejtën këmbët çdo gomarit Pushteti i pakufizuar 'kurth' për...
16 Maj, 2023

"Bastionet u humbën një nga një"/ Gjekmarkaj flet 'pa dorezë': Përpëlasjet e brendshme në opozitë, gjuha 'e egër' e përdorur mes tyre lanë në shtëpi mijëra qytetarë
16 Maj, 2023

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.